



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dostizuar Prilapsi / Prodato Received / Delivered	01 - 02 / 2023	3	vite god Year
Organ / Bjesa Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKP/MSHCK	1193 / 2023	113
Titull / Protokoll Tit. / Prot. Prot. No.		Shifra e Protog. Appendix	Sasia Kolicitimi Quantity



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1293/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1293/2022 të datës 28.12.2022 të parashtruar nga ankuesi _____, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1293/2022 e datës 28.12.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 28.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 8518/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 07.12.2022 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga 7.5 në 8.5 për periudhën nga janari 2015 deri në nëntor 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 16.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8518/2022 të datës 28.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.855/2022 të datës 08.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshim dhe Plotësimin e Akt Emërimit Nr.01-112/01-0106395/22 i datës 30.11.2022; Kërkesë për kompensim retroaktiv e datës 05.12.2022 e parashtruar nga ankuesi; Përgjigjen në kërkesë e datës 07.12.2022 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore për ankuesin; Plotësimin e ankesës nga ankuesi e datës 04.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 27/2023 e datës 04.01.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 356/2023 e datës 16.01.2023; Listën e pagave për ankuesin e muajit nëntor dhe dhjetor 2022.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës Shef i Sektorit të Pylltarisë. I njëjti më datë 04.10.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.855/2022 të datës 08.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, më datë 30.11.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimit Nr.01-112/01-0106395/22 më koeficient tetë pikë pesë (8.5).

Ankuesi më datë 05.12.2022 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga janari 2015 deri nëntor 2022. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 07.12.2022 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 05.12.2022 me arsyetimin se koeficienti i pagës 8.5 do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 07.12.2022 të organit të punësimit, ankuesi me datë 28.12.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive nga janari 2015 e deri nëntor 2022.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 04.01.2012 kishte nënshkruar aktin e emërimit për pozitën e punës *Shef i Sektorit të Pylltarisë*, me koeficient të pagës shtatë pika pesë (7.5), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në detyrë lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 04.10.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikuueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 04.01.2012), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohet se: 130.1. *Ankimi*



administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1293/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesionale

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

